



BASHKIA VLORE

# "Rikonstruksion i Palestrës Multisportive të Ekipit Flamurtari"

## 1. Vendodhja ne lidhje me Qytetin e Vlores

Zona e marre ne studim eshte nje zone kryesore e cila pozicionohet ne qender te qytetit te Vlores.

Ne saj te pozicionit, kjo kufizohet nga rruge qe perbejne arterie kryesore me rendesi te larte ekonomike.

Ne qender te ketij blloku banimi ndodhet kampusi universitar, nje nder zonat me te frekuentuara nga studentet pasi aty ndodhen godinat e studimit si dhe konviktet.

Kjo zone kohet e fundit ka marre zhvillim si pasoje e nderhyrjeve te rikonstruksionit te Bulevardit Ismail Qemali dhe te Rruges Sulejman Delvina, si edhe gjithe investimit te kryer ne kete bllok banimi.

Ne vijim te kampusit universitar, ndodhet godina e Palestres se Qytetit, palestra Flamurtari.



Palestra perbehet nga 1 salle loje per volejboll, 1 salle loje per basketboll si edhe ambientet ndihmese tualet, dhome zhveshje si edhe zyra.


Objekti i eshte nenshtuar rikonstruksionit ne vitin 2021 ne pjesen e jashtme te tij, nderhyrje ne fasade, si edhe mbulesen ekzsituase.

Aktualisht sherben si zone sportive ne qytet.

Siperfaqja e godines eshte rreth 1100 m<sup>2</sup> ku rreth 85 m<sup>2</sup> eshte oborri i brendshem.

## 2. Gjendja ekzistuese

Objekti ka 1 hyrje kryesore e cila te con ne ambientet e sherbimit, tualet si edhe zyra. Nepermjet nje korridori te brendshem aksesohet salla e volejbollit, e cila aktualisht ka vetem nje dere funksionale pasi dera tjeter eshte mbyllur me mur tulle. Gjendja paraqitet e degratuar ne pjesen e tualeteve, dyert e brendshme jane duralumin me xham, te amortizuara me kalimin e kohes. Salla e volejbollit eshte ne gjendje te degraduar, si persa i perket parketit dhe nenshtresave ashtu edhe elementeve te nevojshem per ushtrimin normal te sportit.



Ne krahun Jugor gjendet nje dere e cila te nxjerr ne oborrin e brendshem, nepermjet te cilit aksesohet salla e madhe e basketbollit. Salla eshte ne gjendje te degraduar, parketi eshte jo funksional si edhe ka nevojte emergjente per nderhyrje ne shtresat dhe nenshtresat e tij. Elementet e nevojshem si koshat, ndricimi etj jane ne gjendje te amortizuar dhe pjeserisht jashte funksionit.




### ***3. Nderhyrjet e parashikuara ne Projekt***

Nderhyrja konsiston ne rikonstrukcionin teresor te brendshem te palestres, ambienteve ndihmese, oborrit te brendshem si edhe nderhyrje ne impjantin hidrosanitar, ngrohje ftohje si edhe te mbrojtjes ndaj zjarrit.

Salla e madhe me nje siperfaqe prej 530 m<sup>2</sup> do ti nenshtrohet rinovimit total. Do te prishen shtresat dhe nenshtresat, pastrim te suvase, prishje pjesisht te murit te brendshem per hapje dere. Do te kemi suvatim te brendshem, lysterje me boje, sistem te ri ndricimi dhe te mbrojtjes ndaj zjarrit.

Nenshtresat dhe shtresa e parketit do te zevendesohen duke krijuar shtresat e reja me parket special te certifikuar si edhe tapet rezine sintetike me ngjyra per terrene sportive.


Koshat e basketbollit do te behen krejtesisht nga e para perfshire edhe lysterjen me boje.



Salla e vogel e volejbollit me nje siperfaqe prej 280 m<sup>2</sup> do te nenshtrohet rinovimit total. Do te prishen shtresat dhe nenshtresat, pastrim te suvase, prishje pjesisht te murit te brendshem per hapje dere. Do te kemi suvatim te brendshem, lysterje me boje, sistem te ri ndricimi dhe te mbrojtjes ndaj zjarrit.

Nenshtresat dhe shtresa e parketit do te zevendesohen duke krijuar shtresat e reja me parket special te certifikuar si edhe tapet rezine sintetike me ngjyra per terrene sportive.

Propozohet vendosja e struktures se re te rrjetes se volejbollit, si edhe vendosja e disa stolave me konstrukcion metalik, te levizshem qe do te sherbejne si pankine dhe tribune.



Shtresat e dyshemese propozohen:

- Shtrese parketi speciale e certifikuar + aksesoret special per palester
- Hidroizolim me dy shtresa guajn
- Zgare metalike 0 12/20 cm
- Shtrese betoni 12 cm
- Tabani ekzistues.

Ne pjesen e oborrit te brendshem propozohet rinovimi teresor i tij.

Duke u nisur nga rikualifikimi i bllokut të shkolles Mjeksore, propozohet shtrim me pllaka të njëjta (pllaka guri gelqeror t 6cm) sipas pllakave të trotuarit aktual (gure lokal Vlore)

Gjithashtu propozohet vendosja e dy stolave guri të njëjta me stolat e bulevardit Ismail Qemali si edhe dy peme Platanus me perimenter mbi 45 cm.

Ne brendesi propozohet edhe një kanal kullues për ujrat e shiut.



#### 4. Plan Organizimi i punimeve, Plani kalendar

Punimet do të zbatohen nga firma kontraktore në përputhje me plan-organizimin dhe planin kalendarik të hartuar dhe miratuar prej 6 muajsh

Në planin kalendarik përcaktohet fillimi dhe mbarimi i objektit, kohezgjatja e çdo lloji punimi që do të kryhet, duke respektuar me rigorozitet kushtet teknike të zbatimit dhe radhën teknologjike.

Në plan organizimin e punimeve parashikohen të gjitha masat organizative për të realizuar punime me cilësi dhe në përputhje me specifikimet teknike.

Në plan organizim përcaktohen:

1. Ngritja e kantjerit
2. Linjat provizore, sidomos ato të furnizimit me energji
3. Vend-depozitimet e materialeve
4. Skemat organizative
5. Levizja provizore e mjeteve të transportit, të makinerive dhe mekanizmave që do të përdoren

Ne plan organizim parashikohen me pergjegjesi masat per sigurimin teknik dhe mbrojtjes ne pune te shoqeruara me pajisjet e domosdoshme dhe mjetet paralajmeruese. Parashikohen burimet nga do te furnizohemi me baze materiale, menyren e shfrytezimit te kavos.

Para fillimit te punimeve hartohet plani kalendarik.

Ne planin kalendar pasqyrohet fillimi i objektit, afati i perfundimit, fillimi dhe mekanizimi i çdo lloj procesi pune duke zbatuar me rigorozitet radhen teknologjike dhe kushtet teknike te zbatimit.

Plani kalendarik shoqerohet :

- grafikun e makinerive dhe pajisjeve;
- skemat e levizjes se makinerive, mekanizmave si dhe skemat e ngritjes per montimin e elementeve te parapergatitur;
- grafikun e fuqise punetore e specialiste
- planin material
- programin mbi organizimin e kontrollit per zbatimin e punimeve ne sasi e cilesi.

Nese gjate zbatimit te punimeve do te haset ne situata jo te parashikuara per te cilat kerkohet ndryshim, per keto ndryshime do te kerkohet dakordesia e projektuesve.

Subjekti ndertues perpara fillimit te punimeve te ndertimit do te njoftoje Inspektoriatin e Mbrojtjes se Territorit Vendor.

Punoi:

Ing. Edi Beqiri



Dr. Klaudio Mehmetaj

